




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 44 Datë 13.06 2023

**“Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit”**

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 48, **Mbledhja e parë e këshillit bashkiak**, pika 5, *Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë*; pika 6, gërma ç) *zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit*; neni 54, **Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**, gërma b) *zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata*; neni 55, pika 3, *Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji*; neni 56, pika 1) *Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit...*, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e tij të parë;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z. Ervis Shimaj, me shumicë të votave , mbështetur në nenin 55, pika 3.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sekretar i Këshillit Bashkiak  
Ardian CEBEPIJA



Këshilltari më i vjetër në moshë  
Erano Prenga

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 25

Vota Kunder 2

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 16.06.23